



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Rektoratin e Universitetit “Aleksander Xhuvani” shpall konkurs për pozicionin e punës 1 (një) personel ndihmësakademik me karakter administrativ, me kohë të plotë, Përgjegjës i Sektorit të IT-së,

Përgjegjësi i Sektorit të IT-së përgjigjet për:

- menaxhimin dhe mbarëvajtjen e burimeve informatike dhe infrastrukturës, duke përfshirë sistemet e shkëmbimit të informacionit, rrjetin kompjuterik hardware (pajisjet kompjuterike) dhe software (programet) si dhe mjetet e tjera të komunikimit në përputhje me legjislacionin në fuqi);
- nxjerr të dhëna statistikore të programuara për MAS dhe institucione të tjera;
- përgjegjës për zgjidhjen e konflikteve e problematikave që lindin brenda sektorit për të dhënë zgjidhje teknike dhe ligjore;
- të zgjidhë mosmarrëveshjet në lidhje me kompetencat e specialistëve të sektorit për ndarje të detyrave e ndjekjen e problemeve;
- kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga eprorët

Kriteret e përgjithshme:

- Të zotërojë diplomë të ciklit (nivelet) të dytë të studimeve Master i Shkencave, në fushën e informatikës.
- Të këtë përvojë pune.
- Të këtë njohuri të paktën e një gjuhe të huaj të vertëtuuar me dokumentacion.
- Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- Ndaj tij të mos këtë masë disiplinore në fuqi.
- Të jetë i aftë për punë.

Kriteret e veçanta:

- Të këtë jo më pak se 5 (pesë) vite pune në sektorin e IT-së
- Të këtë mbi 3(tri) punë në një institucion të arsimit të lartë.
- Të këtë kryer trajnime apo kualifikime në fushën përkatëse
- Të këtë aftësi të mira menaxhuese, komunikuese e të punës në grup.

Kandidatët duhet të dorëzojnë në rrugë postare në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore Protokoll Arkiv të Rektoratit të Universitetit të Elbasanit “Aleksander Xhuvani” brenda 10 (dhjetë) ditëve (**24.01.2022 - 02.02.2022**) nga data e shpalljes në www.app.gov.al dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

- Letër motivimi për pozicionin e punës Përgjegjësi i Sektorit të IT-së në Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
- Jetëshkrimin e tij/saj;
- Fotokopje e diplomës e njehsuar me origjinalin. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njehsuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- Fotokopje e listës së notave e njehsuar me origjinalin. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar;
- Fotokopje e njehsuar e librezës së punës;
- Çertifikata, kualifikime, dëshmi, për aftësi të ndryshme, të njehsuara me origjinalin;
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj e njehsuar me origjinalin;
- Raport i gjendjes shëndetsore, që vërteton aftësinë për punë;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Fotokopje e letërnjoftimit.

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në **rrugë postare** brenda 10 (dhjetë) ditëve (24.01.2022 - 02.02.2022) nga data e shpalljes në www.app.gov.al në adresën:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,
Rruga “Ismail Zyma”,
Aplikim për pozicionin e punës: Përgjegjësi i Sektorit të IT
Elbasan**

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e **Rektoratit**. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do të nënshtohen intervistës me gojë (04.02.2022 – 16.02.2022). Kandidatët konkures do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen /njoftimi i fituesit.